



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI I BASHKISË ✓

5751
Nr. _____ Prot

Himarë, më 11.08.2026

VENDIM
NR. 40 DATË 30/07/2026

“PËR ZBATIMIN DHE REFLEKTIMIN NË BUXHET TË NDRYSHIMIT SIPAS VKM NR.536 DATË 09.07.2026 “PËR PROPOZIMIN E MIRATIMIT TË SHITIMIT TË FONDEVE BUXHETORE PËR FINANCIMIN E FUNKSIONIT "MBROJTJE NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI" DHE NJË NDRYSHIM BUXHETOR MBI BUXHETIN E VITIT 2026,NË VKB NR.32 DATË 30.06.2026 “PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE BUXHETORE MBI BUXHETIN E VITIT 2026”.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor” i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, ”, VKB nr.32 datë 30.06.2026 “Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026” po ju dërgojmë relacionin dhe vendimin “Për zbatimin dhe reflektimin në buxhet të ndryshimit sipas vkm nr.536 datë 09.07.2026 “për propozimin e miratimit të shtimit të fondeve buxhetore për financimin e funksionit "mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi" dhe një ndryshim buxhetor mbi buxhetin e vitit 2026,në vkb nr.32 datë 30.06.2026 “për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026”, të cilat janë miratuar në mbledhjen e datës 30.07.2026 me 13 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim.

VENDOSI:

1. Të miratohet propozimi i miratimit të shtimit të fondeve buxhetore për financimin e funksionit “mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi” sipas vkm 536 datë 09.07.2026.
2. Të miratohet ndryshimi buxhetor në vkb nr.32 datë 30.06.2026 “Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 5265/2 Prot

Himarë, më 17.07.2026

RELACION

“PËR ZBATIMIN DHE REFLEKTIMIN NË BUXHET TË NDRYSHIMIT SIPAS VKM NR.536 DATË 09.07.2026 “PËR PROPOZIMIN E MIRATIMIT TË SHITIMIT TË FONDEVE BUXHETORE PËR FINANCIMIN E FUNKSIONIT "MBROJTJE NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI" DHE NJË NDRYSHIM BUXHETOR MBI BUXHETIN E VITIT 2026,NË VKB NR.32 DATË 30.06.2026 “PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE BUXHETORE MBI BUXHETIN E VITIT 2026”.

BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026";
- Akti Normativ nr. 2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 'Për buxhetin e vitit 2026'";
- Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar;
- Shkresa e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore, nr. 11219/3, datë 06.07.2026 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026", protokolluar në Bashkinë Himarë me nr. 5087 Prot., datë 09.07.2026;
- VKM nr.536 datë 09.07.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.203 datë 10.04.2019, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- VKB nr.32 datë 30.06.2026 “ Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026”

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 'Për buxhetin e vitit 2026'", Ministria e Financave ka njoftuar zyrtarisht Bashkinë Himarë, nëpërmjet shkresës nr. 11219/3, datë 06.07.2026, mbi shtimin e fondeve në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe në transfertën e pakushtëzuar sektoriale, të destinuara për financimin e funksionit "Mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi" si dhe VKM nr.536 datë

09.07.2026“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.203 datë 10.04.2019, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, pika 1, shkronja a ndryshohet pika 4, kreu I, shtohen pikat 4/1, 4/2, 4/3, 6/1 dhe pika 8 kreu I shfuqizohet dhe VKB nr.32 datë 30.06.2026 “ Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026”.

Sipas tabelës shpjeguese bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, për Bashkinë Himarë (Kodi i Institucionit 2160001, Entiteti Qeverisës 160) janë shtuar dy zëra fondesh, të cilët paraqiten të përqendruar në programin buxhetor 03280 "Shërbime të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", në zërin ekonomik 604, të destinuara për funksionimin e shërbimit të zjarrfikësve, përkatësisht: fondi me kod projekti 90001AA dhe kod thesari 3737, në vlerën 1,276,000 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë; dhe fondi me kod projekti 90005AA dhe kod thesari 3737, në vlerën 623,099 (gjashtëqind e njëzet e tre mijë e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

Gjithashtu do të hiqet në programin buxhetor 09120 “Arsimi baze përfshirë arsimin parashkollor”, llogaria 231, projekti me objekt “Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Spiro Gjikhuri” me bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit për arsye se ky projekt nuk ka marr aprovimin nga Ministria e Arsimit për të investuar, pasi ka një investim të zhvilluar 10 vitet e fundit dhe do të shtohet në programin buxhetor 08220 “Trashëgimia kulturore, evente artistike dhe kulturore” projekti me objekt “Muzeu i Blektorisë së Pilurit” me bashkëfinancim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit sipas aplikimit.

Tabela shpjeguese:

Programi buxhetor	Llogaria	Pershkrimi i projektit	Ishte	Behet
03280	600+601	Paga dhe sigurime per zjarrfikesit	-	1,276,000.00
03280	602	Shpenzime per MZSH	-	623,099.00
09120	231	Bashkefinancim “Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Spiro Gjikhuri”	20,000,000.00	-
08220	231	Bashkefinancim “Muzeu i Blektorisë së Pilurit”	-	20,000,000.00

Në vijim paraqitet përmbledhja e elementëve thelbësorë të aplikimit për skemën e granteve “Mbështetje për fuqizimin e kapaciteteve menaxhuese të bashkive nëpërmjet aplikimit të skemave të granteve, Faza II”, pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), aplikim i cili, sipas relacionit të mësipërm, është pjesë integrale e këtij dokumenti dhe bazë për shtimin e projektit në programin buxhetor 08220 “Trashëgimia kulturore, evente artistike dhe kulturore”.

2. Përshkrimi dhe qëllimi i projektit

Projekti synon krijimin e një muzeu tematik në fshatin Pilur, kushtuar historisë së blektorisë, transhumancës dhe jetës baritore, si dhe lidhjes së tyre me kulturën dhe identitetin e Labërisë. Muzeu do të dokumentojë dhe ekspozojë objekte tradicionale, do të mbledhë dëshmi gojore të banorëve, do të krijojë një arkiv fotografik, dokumentar dhe audioviziv, dhe do të shndërrohet në një qendër interpretimi të trashëgimisë kulturore dhe një destinacion të ri të turizmit kulturor gjatë gjithë vitit.

Nevoja për projektin lidhet me rrezikun e humbjes së trashëgimisë blegtorale dhe të mënyrës tradicionale të jetesës në Pilur, si pasojë e emigracionit, plakjes së popullsisë dhe mungesës aktuale të një hapësire të dedikuar për ruajtjen dhe interpretimin e kësaj trashëgimie.

3. Objektivat kryesorë dhe përfituesit

- Krijimi i një muzeu modern, funksional sipas standardeve bashkëkohore, kushtuar historisë së blektorisë;
- Mbledhja, restaurimi dhe ekspozimi i objekteve tradicionale, si dhe dokumentimi i kujtesës gojore dhe traditave baritore;
- Krijimi i një arkivi dixhital (fotografik, dokumentar, audioviziv) të trashëgimisë kulturore të Pilurit;
- Rritja e numrit të vizitorëve dhe zgjatja e sezonit turistik në Bashkinë Himarë, përmes një produkti të ri të turizmit kulturor;
- Krijimi i një modeli të qëndrueshëm menaxhimi kulturor e turistik dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë, komunitetit dhe institucioneve kulturore.

Përfituesit e drejtpërdrejtë vlerësohen në rreth 220 banorë, 15 biznese lokale dhe 350 turistë/vizitorë, ndërsa në afat më të gjatë projekti pritet të gjenerojë 3.000–5.000 vizitorë në vit.

4. Plani i aktiviteteve dhe buxheti

Zbatimi i projektit parashikohet të realizohet nëpërmjet pesë aktiviteteve/kontratave kryesore: (1) Hartimi i projektit teknik dhe dokumentacionit zbatues, me buxhet 1.500.000 lekë, financuar nga NJVV, me fillim të parashikuar më 01/08/2026 dhe përfundim më 01/10/2026; (2) Restaurimi dhe përshtatja e godinës së muzeut, me buxhet 24.000.000 lekë, financuar nga FSHZH, me fillim më 20/10/2026 dhe përfundim më 20/04/2027; (3) Krijimi dhe kurimi i ekspozitës muzeale, me buxhet 8.000.000 lekë, financuar nga NJVV, me fillim më 01/11/2026 dhe përfundim më 15/02/2027; (4) Krijimi i arkivit dixhital të trashëgimisë, me buxhet 5.000.000 lekë, financuar nga NJVV, me fillim më 01/11/2026 dhe përfundim më 15/02/2027; dhe (5) Pajisja me teknologji interaktive dhe elementë smart, me buxhet 7.000.000 lekë, financuar nga NJVV, me fillim më 01/11/2026 dhe përfundim më 15/02/2027.

Buxheti i përgjithshëm i projektit është 45.500.000 lekë, prej të cilit 24.000.000 lekë (rreth 52.7%) financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), ndërsa 21.500.000 lekë (rreth 47.3%) përbëjnë bashkëfinancimin e Bashkisë Himarë; nuk parashikohet financim nga donatorë të tjerë.

5. Qëndrueshmëria e projektit

Qëndrueshmëria financiare do të garantohet nëpërmjet të ardhurave nga aktiviteti i muzeut (bileta, guida, evente, shitje produktesh tradicionale), mbështetjes institucionale të vazhdueshme nga Bashkia Himarë, si dhe mundësive për financime shtesë nga programe kombëtare e ndërkombëtare. Qëndrueshmëria institucionale garantohet nëpërmjet integritit të muzeut në strukturat dhe politikat e Bashkisë Himarë, ngritjes së kapaciteteve të stafit lokal dhe përfshirjes aktive të komunitetit të Pilurit si bashkë-krijues dhe “pronar” vendor i rezultateve të projektit.


DREJTORI I F.P.B.M.A

Besa Xhaferi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 536, datë 9.7.2026

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.203,
DATË 10.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË MASËS SË PËRFITIMIT
DHE LLOJEVE TË PUSHIMEVE TË TJERA, ME APO PA PAGESË,
NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.203, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 4, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, që shërben natën, në ditët e pushimit javor e të festave zyrtare, brenda kohëzgjatjes normale të punës, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:

- a) 20% për çdo orë pune e shërbimi të kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00;
- b) 50% për çdo orë pune e shërbimi të kryer nga ora 22:00 deri në orën 6:00;

c) 25% për çdo orë pune të kryer në ditët e festave zyrtare dhe në ditët e pushimit javor.”.

b) Pas pikës 4, të kreut I, shtohen pikat 4/1, 4/2 dhe 4/3, me këtë përmbajtje:

“4/1. Për orët shtesë të punës, punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së kompensohet me pushim të barabartë me orët shtesë plus 25% të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune apo me orët shtesë plus 50% të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00 - 6:00.

4/2. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, kur festat zyrtare bien në ditë pushimi, trajtohet me një ditë pushimi shtesë ose pagesë për 8 (tetë) orë, të përlllogaritur mbi pagën orare të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu.

4/3. Shtesa mbi pagë, sipas pikës 4, të këtij kreu, paguhet bashkë me pagën mujore, brenda një muaji nga dita kur është kryer shërbimi. Kompensimi me pushim i orëve shtesë të punës, sipas pikave 4/1 e 4/2, të këtij kreu, bëhet brenda 2 (dy) muajve nga dita kur janë kryer ato. Në rast të pamundësisë së kompensimit të orëve shtesë të punës me pushim, punonjësi kompensohet me shtesë page, sipas masës së përcaktuar në pikat 4/1 e 4/2, të këtij kreu.”.

c) Pas pikës 6, të kreut I, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Numri maksimal i orëve shtesë për punonjësin operacional të shërbimit të MZSH-së nuk mund të jetë më shumë se 200 (dyqind) orë në vit. Me autorizimin e inspektoratit përgjegjës për inspektimin e punës, numri maksimal i orëve shtesë mund të tejkalohet vetëm në rastet e forcës madhore ose të menaxhimit të emergjencave civile në dobi të popullsisë.”.

ç) Pika 8, e kreut I, shfuqizohet.

d) Në pikën 1, të kreut II, emërtimet “komisar zjarrfikës”, “kryeinspektor zjarrfikës” dhe “inspektor zjarrfikës” zëvendësohen, përkatësisht, me “kryekomisar zjarrfikës”, “komisar zjarrfikës” dhe “nënkomisar zjarrfikës”.

2. Efektet financiare shtesë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkitë.


NR.PROT. 1301/1
DATE 10. 7 .2026

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDASHME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMIN
TË GJITHA BASHKIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Elsonida RAMA





(Andhur fotokopje)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 11219/3 prot.

Tiranë, më 07.2026

Lënda: Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026

DEGËS SË THESARIT -

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

BASHKISË HIMARË

Në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, ju dërgojmë detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, sipas tabelës bashkëlidhur, në lekë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri



Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"

në lekë

Ent. Qev.	MIn.Linj	Kodi Inst.	Emër Inst.	Kap	Programi	Ulogaria Ekonomike	Kod projekti	Kodi Thesarit	TOTALI
SHITES									
152	00	2152001	Bashkia Belsh	01	03280	6040000	90001AA	0808	1,007,000
102	00	2102001	Bashkia Berat	01	03280	6040000	90001AA	0202	2,915,000
103	00	2103001	Bashkia Bulqize	01	03280	6040000	90001AA	0603	1,095,000
110	00	2110001	Bashkia Cerrik	01	03280	6040000	90001AA	0808	1,007,000
104	00	2104001	Bashkia Delvine	01	03280	6040000	90001AA	3704	1,276,000
105	00	2105001	Bashkia Devoll	01	03280	6040000	90001AA	1505	1,095,000
106	00	2106001	Bashkia Diber	01	03280	6040000	90001AA	0606	1,825,000
147	00	2147001	Bashkia Divjake	01	03280	6040000	90001AA	0922	1,095,000
452	00	2452001	Bashkia Dropull	01	03280	6040000	90001AA	1111	1,007,000
107	00	2107001	Bashkia Durres	01	03280	6040000	90001AA	0707	4,375,000
109	00	2109001	Bashkia Elbasan	01	03280	6040000	90001AA	0808	2,735,000
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	03280	6040000	90001AA	0909	3,100,000
326	00	2326001	Bashkia Finiq	01	03280	6040000	90001AA	3704	1,369,000
155	00	2155001	Bashkia F-Arrez	01	03280	6040000	90001AA	3330	1,276,000
115	00	2115001	Bashkia Gjirokastrë	01	03280	6040000	90001AA	1111	2,555,000
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	01	03280	6040000	90001AA	0810	1,276,000
117	00	2117001	Bashkia Has	01	03280	6040000	90001AA	1812	1,007,000
160	00	2160001	Bashkia Himare	01	03280	6040000	90001AA	3737	1,276,000
166	00	2166001	Bashkia Kamëz	01	03280	6040000	90001AA	3535	3,645,000
118	00	2118001	Bashkia Kavaje	01	03280	6040000	90001AA	3513	1,460,000
154	00	2154001	Bashkia Kelenje	01	03280	6040000	90001AA	1128	1,095,000
654	00	2654001	Bashkia Klos	01	03280	6040000	90001AA	0625	1,095,000
120	00	2120001	Bashkia Kolonjë	01	03280	6040000	90001AA	1514	1,095,000
156	00	2156001	Bashkia Konispol	01	03280	6040000	90001AA	3731	1,276,000
122	00	2122001	Bashkia Korçe	01	03280	6040000	90001AA	1515	2,915,000
123	00	2123001	Bashkia Krujë	01	03280	6040000	90001AA	0716	1,460,000
124	00	2124001	Bashkia Kuçovë	01	03280	6040000	90001AA	0217	1,276,000
125	00	2125001	Bashkia Kukes	01	03280	6040000	90001AA	1818	4,375,000
126	00	2126001	Bashkia Kurbin	01	03280	6040000	90001AA	2019	1,369,000
127	00	2127001	Bashkia Lezhe	01	03280	6040000	90001AA	2020	3,010,000
116	00	2116001	Bashkia Libohovë	01	03280	6040000	90001AA	1111	1,095,000
128	00	2128001	Bashkia Librazhd	01	03280	6040000	90001AA	0821	1,276,000
129	00	2129001	Bashkia Lushnjë	01	03280	6040000	90001AA	0922	1,276,000
130	00	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	01	03280	6040000	90001AA	3323	1,825,000
168	00	2168001	Bashkia Maliq	01	03280	6040000	90001AA	1515	1,369,000
131	00	2131001	Bashkia Mallakastrë	01	03280	6040000	90001AA	0924	1,095,000
132	00	2132001	Bashkia Mat	01	03280	6040000	90001AA	0625	1,27

Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026".

në lekë

Ent. Qev.	Mlin.Linj.	Kodi Inst.	Emër Inst.	Kap	Programi	Llogaria Ekonomike	Kod projekti	Kodi Thesarit	TOTALI
SHITES									
152	00	2152001	Bashkia Belsh	01	04960	6040000	90005AA	0808	673,357
102	00	2102001	Bashkia Berat	01	04960	6040000	90005AA	0202	1,847,595
103	00	2103001	Bashkia Bulqize	01	04960	6040000	90005AA	0603	1,399,304
110	00	2110001	Bashkia Cernik	01	04960	6040000	90005AA	0808	840,912
104	00	2104001	Bashkia Delvine	01	04960	6040000	90005AA	3704	339,144
105	00	2105001	Bashkia Devoll	01	04960	6040000	90005AA	1505	1,113,915
106	00	2106001	Bashkia Diber	01	04960	6040000	90005AA	0606	2,146,389
147	00	2147001	Bashkia Divjake	01	04960	6040000	90005AA	0922	1,103,665
452	00	2452001	Bashkia Dropull	01	04960	6040000	90005AA	1111	472,066
107	00	2107001	Bashkia Durres	01	04960	6040000	90005AA	0707	5,344,970
109	00	2109001	Bashkia Elbasan	01	04960	6040000	90005AA	0808	3,756,778
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	04960	6040000	90005AA	0909	3,368,129
326	00	2326001	Bashkia Finiq	01	04960	6040000	90005AA	3704	709,042
155	00	2155001	Bashkia F-Arrez	01	04960	6040000	90005AA	3330	404,915
115	00	2115001	Bashkia Gjirokastrë	01	04960	6040000	90005AA	1111	1,125,310
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	01	04960	6040000	90005AA	0810	1,118,586
117	00	2117001	Bashkia Has	01	04960	6040000	90005AA	1812	748,864
160	00	2160001	Bashkia Himare	01	04960	6040000	90005AA	3737	623,099
166	00	2166001	Bashkia Kamëz	01	04960	6040000	90005AA	3535	3,016,501
118	00	2118001	Bashkia Kavaje	01	04960	6040000	90005AA	3513	1,184,526
154	00	2154001	Bashkia Kelenje	01	04960	6040000	90005AA	1128	339,830
654	00	2654001	Bashkia Klos	01	04960	6040000	90005AA	0625	723,643
120	00	2120001	Bashkia Kolonjë	01	04960	6040000	90005AA	1514	624,389
156	00	2156001	Bashkia Konispol	01	04960	6040000	90005AA	3731	340,272
122	00	2122001	Bashkia Korçe	01	04960	6040000	90005AA	1515	2,361,321
123	00	2123001	Bashkia Kruje	01	04960	6040000	90005AA	0716	1,585,099
124	00	2124001	Bashkia Kuçove	01	04960	6040000	90005AA	0217	994,048
125	00	2125001	Bashkia Kukës	01	04960	6040000	90005AA	1818	1,893,049
126	00	2126001	Bashkia Kurbin	01	04960	6040000	90005AA	2019	1,231,728
127	00	2127001	Bashkia Lezhe	01	04960	6040000	90005AA	2020	1,811,793
116	00	2116001	Bashkia Libohove	01	04960	6040000	90005AA	1111	213,898
128	00	2128001	Bashkia Librazhd	01	04960	6040000	90005AA	0821	1,438,389
129	00	2129001	Bashkia Lushnje	01	04960	6040000	90005AA	0922	2,211,241
130	00	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	01	04960	6040000	90005AA	3323	1,522,396
168	00	2168001	Bashkia Maliq	01	04960	6040000	90005AA	1515	1,562,837
131	00	2131001	Bashkia Mallakastër	01	04960	6040000	90005AA	0924	819,808
132	00	2132001	Bashkia Mat	01	04960	6040000	90005AA	0625	1,011,588
143	00	2143001	Bashkia Memaliaj	01	04960	6040000	90005AA	1134	538,655
133	00	2133001	Bashkia Mirditë	01	04960	6040000	90005AA	2026	1,035,819
112	00	2112001	Bashkia Patos	01	04960	6040000	90005AA	0909	670,658
134	00	2134001	Bashkia Peqin	01	04960	6040000	90005AA	0827	704,719
135	00	2135001	Bashkia Përmet	01	04960	6040000	90005AA	1128	610,095
136	00	2136001	Bashkia Pogradec	01	04960	6040000	90005AA	1529	1,884,548
140	00	2140001	Bashkia Polican	01	04960	6040000	90005AA	0232	510,248
153	00	2153001	Bashkia Prezjas	01	04960	6040000	90005AA	0821	905,162
137	00	2137001	Bashkia Pukë	01	04960	6040000	90005AA	3330	574,697
499	00	2499001	Bashkia Pustec	01	04960	6040000	90005AA	1515	181,461
113	00	2113001	Bashkia Roskovec	01	04960	6040000	90005AA	0909	577,668
119	00	2119001	Bashkia Rrogozhine	01	04960	6040000	90005AA	3513	764,398
138	00	2138001	Bashkia Sarandë	01	04960	6040000	90005AA	3731	795,795
159	00	2159001	Bashkia Selenice	01	04960	6040000	90005AA	3737	892,582
108	00	2108001	Bashkia Shijak	01	04960	6040000	90005AA	0707	764,030
141	00	2141001	Bashkia Shkoder	01	04960	6040000	90005AA	3333	3,486,177
139	00	2139001	Bashkia Skrapar	01	04960	6040000	90005AA	0232	645,330
142	00	2142001	Bashkia Tepelene	01	04960	6040000	90005AA	1134	483,954
101	00	2101001	Bashkia Tiranë	01	04960	6040000	90005AA	3535	15,182,303
145	00	2145001	Bashkia Tropojë	01	04960	6040000	90005AA	1836	1,064,168
167	00	2167001	Bashkia Dimal	01	04960	6040000	90005AA	0202	808,422
157	00	2157001	Bashkia V.Dejes	01	04960	6040000	90005AA	3333	1,166,904
146	00	2146001	Bashkia Vlore	01	04960	6040000	90005AA	3737	3,025,680
165	00	2165001	Bashkia Vore	01	04960	6040000	90005AA	3535	704,140
Total									90,000,000